



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.10.2020 merr këtë

V E N D I M
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale, në kategoritë "*Subvencione dhe transfere*" dhe "*Mallra dhe shërbime*".

Neni 2

Sipas pikës I të këtij vendimi, nga fondi i rezervës komunale, mjetet në vlerë prej 2,497,260.13 €, orientohen në Administratën komunale, gjegjësisht mjetet në vlerë prej 497,260.13 € orientohen në kategorinë e *mallrave dhe shërbimeve* dhe mjetet në vlerë prej 2,000,000.00 € orientohen në kategorinë e *subvencioneve dhe transfereve*.

Neni 3

Sipas pikës II të këtij vendimi, shuma e mjeteve të transferuara është 2,497,260.13 €.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelore me detajet e hollësishme.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0179382/20, më 02.10.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kulefa

